



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201501115/2

Tiranë ___/___/2015

Lënda : *Rekomandime për inspektimin e bërë në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Shkodër dhe Komisaritet në varësi të saj.*

Drejtuar : **Z.Haki ÇAKO**
Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit

TIRANË

Z.Lorenc PANGANIKA
Drejtorit të Policisë së Qarkut Shkodër

SHKODËR

Të nderuar zotërinj,

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës në mbështetje të nenit 19/1 të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, inspektoi Drejtorinë e Policisë së Qarkut Shkodër dhe Komisaritet në varësi të saj.

Inspektimet u kryen në datat 1,2,3.06.2015 nga ekspertët e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në bazë të një Plan Inspektimi të miratuar më parë nga Avokati i Popullit.

Grupi i punës inspektoi objektet si më poshtë:

- Komisariatit e Policisë Shkodër
- Komisariatit e Policisë Pukë
- Komisariatit e Policisë Malësi e Madhe

Shënime Paraprake

Monitorimi kishte si objekt mbledhjen e vlerësimit e të dhënave mbi veprimet dhe praktikat e ndjekura nga njësitë policore në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin (në fuqi në momentin e inspektimit dhe hartimit të raportit) nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe në Manualin “Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimin e të Ndaluara dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, si dhe vlerësimit e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit lidhur me ndërtimin e dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë sipas standardeve ligjore, nxjerrjen jashtë funksionit të dhomave që nuk plotësojnë kriteret e domosdoshme, si dhe zbatimin e kërkesave të ligjit për procedurat e shoqërimit apo ndalim/arrestimit.

Lidhur me referencat ligjore, grupi i monitorimit u bazua si më poshtë:

- Ndalimi/arrestimi i personave të dyshuar për vepra penale rregullohet nga Kodi i Procedurës Penale (KPP), që është në fuqi prej gushtit të vitit 1995 (me ndryshimet e mëvonshme). Një i dyshuar për kryerjen e një vepra penale mund të mbahet nga policia në bazë të kompetencave të saj deri në 48 orë. Brenda kësaj periudhe, rasti duhet t'i referohet prokurorit përkatës, i cili e sjell atë në vëmendjen e gjyqtarit kompetent po brenda afatit kohor 48 orë¹ nga momenti i arrestimit (përveç rasteve kur Prokurori urdhëron lirimin e menjëhershëm të personit)². Më pas, gjyqtari brenda 48 orësh nga momenti i paraqitjes në gjykatë të kërkesës së prokurorit, mban seancën gjyqësore duke shpallur vendimin dhe caktuar masën e sigurisë duke e lënë personin në arrest ose vendos lirimin e menjëhershëm të të ndaluar/arrestuarit.³
- Personat për të cilët gjykata ka vendosur masën e sigurisë “*arrest me burg*” duhet të transferohen në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe ambiente të tjera në pritje të gjyqit⁴.
- Lidhur me identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, Kodi i Procedurës Penale, në nenin 295 të tij, ka përcaktuar afatin deri në dymbëdhjetë orë, kohë në të cilën policia lejohet të mbajë çdo person që refuzon të japë identitetin e tij ose dyshohet për përdorimin e një identiteti të rremë. Më tej, në përputhje me Ligjin “Për policinë e shtetit”, një person mund të dërgohet në ambientet e Policisë, për një periudhë që nuk i kalon dhjetë orë, në rastet e mëposhtme: mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent, ose kur një person është subjekt epidemie i një sëmundjeje ngjitëse, i pa aftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë.

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit, grupi i punës zhvilloi fillimisht takime me drejtuesit e këtyre institucioneve dhe u komunikoi

¹ Neni 258 par 1, i KPP

² Neni 257 i KPP

³ Neni 258 par 2; neni 259 i KPP

⁴ Neni 259 i KPP, par. 3,4

atyre qëllimin e vizitës. Drejtuesit u shprehën të gatshëm dhe bashkëpunues duke i ofruar grupit inspektues mundësinë për akses brenda rregullave dhe pa vështirësi në të gjithë personat dhe ambientet që duhej të monitoronin.

Gjatë inspektimeve, ekipi pati konsultime me Shefat e Rendit dhe të Sigurisë Publike në Komisaritet e Policisë Shkodër, Pukë dhe Malësi e Madhe si dhe me zyrtarë të tjerë të këtyre njësive policore, nga ku mori informacionin e nevojshëm. Më pas ekipi kontaktoi privatisht me personat e privuar nga liria, inspektoi ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe u njoh me të gjithë dokumentacionin e pasqyruar në regjistrat dhe aktet përkatëse.

Kushtet e ambienteve të shoqërimit:

Në Komisaritin e Policisë Shkodër, mjediset e shoqërimit ishin në katin e parë të godinës të lidhura me një korridor me përmasa 5.5 x 2m. Ambienti kishte tre dhoma shoqërimi, me përmasa pothuajse të njëjta 3.5 x 4m, me ndriçim nga rrjeti, me dritare normale nga të cilat krijohet mundësi për ajrim e ndriçim të plotë natyral, të lyera dhe të pastra, me tualet me ujë të rrjedhshëm. Dyert e dhomave ishin prej druri, por të veshura me llamarinë hekuri dhe mbylleshin me shul dhe dryna. Dhomat ishin të ftohta, pasi nuk kishin ngrohje. Mungonin orënditë e nevojshme si tavolina dhe karrige për akomodimin e personave të shoqëruar. Këto dhoma përdorshin për personat e shoqëruar madhorë meshkuj, pasi për personat e shoqëruar femra dhe të mitur përdorej një ambient tjetër, i cili ndodhej në hyrje të Komisaritatit ngjitur më dhomën e specialistit të informacionit. Ky ambient ka qenë i përshtatshëm për një funksion të tillë pasi ishte rikonstruktuar dhe mobiluar para dy viteve, por gjatë inspektimit u gjet në një gjendje të degraduar, me ndenjësë të dëmtuara, mungesë tavolinash e ndriçimi artificial dhe kushte higjieno-sanitare që linin për të dëshiruar.

Në Komisaritin e Policisë Pukë, kishte një dhomë shoqërimi, e cila ndodhej në katin e dytë të ndërtesës. Dhoma ishte e lyer dhe e pastër, me përmasa 3 x 3.5m, me derë druri, me ndriçim nga rrjeti e me dritare me përmasa 1.5 x 1.5m, që krijonin mundësi për ajrim e ndriçim natyral të mjaftueshëm. Aty mungonte ngrohja dhe orënditë e nevojshme si tavolinë, karrige apo stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Dhoma përdorej vetëm për personat e shoqëruar madhorë meshkuj. Të shoqëruarit femra dhe të mitur mbaheshin në korridoret e Komisaritatit të Policisë.

Ambientet e vjetra të shoqërimit ishin nxjerrë jashtë funksionit⁵, si ambiente jashtë standardeve të përcaktuara në aktet normative, në zbatim të rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit në vitet e shkuara. Mbajtja dhe trajtimi i personave të shoqëruar në këto komisaritate policie kryhej në ambientet e zyrave të punonjësve të policisë, të përcaktuar në këtë urdhër.

Në Komisaritin e Policisë Malësi e Madhe, kishte vetëm një dhomë shoqërimi, me përmasa 4 x 3.5 m, me derë druri të veshur me llamarinë, mbyllja

⁵ Urdhër Nr.239, datë 28.05.2012 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

e të cilës bëhej me shul dhe me dry. Dhoma kishte ndriçim natyral dhe ndriçim nga rrjeti elektrik, por mungonin orenditë e nevojshme për qëndrim.

Sikurse u përmend më lartë, në të tre komisariatet e policisë, nuk kishte dhoma shoqërimi për kategoritë femra dhe për të mitur sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Në momentin e inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Kushtet dhe trajtimi i personave të ndaluar /arrestuar në ambientet e sigurisë:

Personat e arrestuar/ndaluar të Policisë së Qarkut Shkodër mbaheshin në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Shkodër. Në këtë komisarariat kishte 14 dhoma sigurie, nga të cilat përdorshin vetëm pesë, sipas rastit, dy për madhorë, një për të mitur, një për femra, një për persona me probleme shëndetësore. Dhomat nuk ishin të ndërtuara sipas kërkesave të Manualit “*Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore*”, pasi sipërfaqja e tyre nuk ishte 10 m², e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m². Në dhoma nuk kishte pajisjet dhe orenditë e nevojshme për jetesë si krevat, tavolinë, stola etj. Dyshekët dhe batanijet ishin shumë të vjetër. Dritaret e dhomave ishin shumë të vogla, me dimensione 40 x 80 cm, të cilat nuk mundësonin qarkullimin e mjaftueshëm të ajrit. Kishte ambient më vete për ajrim, por nuk përdorej, pasi ishte tepër i amortizuar. Për sa më lart, qëndrimi i shtetasve në këto kushte, përbën trajtim degradues, si dhe cenon dinjitetin e çdo personi që ndalohet në këto ambiente.

Gjatë monitorimit në këto ambiente kishte 4 persona të ndaluar/arrestuar. Gjatë intervistës me këto persona, grupi i punës u informua se personat e ndaluar/ arrestuar ishin trajtuar në mënyrë korrekte përgjatë kohës së ndalimit/ arrestimit të tyre. Nuk u konstatua asnjë rast trajtimi denigrues, jo human apo për ushtrim dhune fizike dhe psikologjike. Shtetasit e ndaluar/arrestuar ishin në gjendje të raportonin identitetin e punonjësit të policisë me të cilin kishin marrë kontakt dhe kishin kryer veprimet procedurale. Gjatë ndalimit/arrestimit të tyre kishin qenë të pranishëm edhe punonjës të tjerë të policisë, por të identifikuar përpara këtyre të fundit.

Për të ndaluarit/ arrestuarit që ishin bartës të sëmundjeve ngjitëse, kishte ambient më vete të ndarë dhe të izoluar nga të tjerët.

Nuk u konstatuan raste që të arrestuarit e mitur të mbahen së bashku me të arrestuarit madhorë.

Të ndaluarit/ arrestuarit trajtoheshin tre herë në ditë me ushqim të përgatitur në kuzhinën e Komisarariatit të Policisë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët Nr.432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë.

Të ndaluarve/ arrestuarve u ofrohej mundësia të lexonin shtypin e ditës, i cili sigurohej me shpenzimet e veta, si dhe u lejohej mbajtja e letrës dhe lapsit për të shkruar, pasta dhe furça e dhëmbëve, pasta e rrojës dhe brisqe rroje plastike. Gjithashtu ata merrnin nga Komisariati i Policisë sapun, detergjente, letra higjienike, letra për fshirjen e duarve e mjete të tjera për ruajtjen e higjienës e pastërtisë vetjake e të ambientit ku qëndronin, sipas normave e rregullave për këtë qëllim.

Nuk kishte mundësi të bisedave telefonike me familjarët, apo dërgimin e letrave nëpërmjet postës etj.

Ndihma juridike dhe psikologjike:

Nga kontaktet dhe informacionet e mbledhura gjatë vizitës u vërejt që për disa prej të intervistuarve ishte siguruar akses tek avokati që në momentin e parë të privimit nga liria,⁶ duke bërë të mundur që avokati të ishte i pranishëm gjatë marrjes në pyetje nga ana e policisë. Për të tjerë, u vërejt se kishte pasur vonesa në aksesin për avokat dhe se deklaratat ishin marrë prej personave të ndaluar/të arrestuar pa praninë e mbrojtësit. Një person i arrestuar pretendoi se ndonëse kishte kërkuar praninë e një mbrojtësi përgjatë kohës së qëndrimit të tij në dhomat e sigurisë, nuk kishte marrë asnjë kontakt me të.

Gjithashtu u konstatua fakti që të ndaluarit/arrestuarit, e kishin të pamundur për të bërë zgjedhjen e mbrojtjes, pasi lista e avokatëve mbrojtës nuk ishte e afishuar.

Ndërsa për të ndaluarit/arrestuarit e mitur, për të cilët ndihma juridike dhe psikologjike është e detyrueshme, u konstatua se në organikën e Drejtorisë së Policisë Qarkut Shkodër ishte parashikuar një specialist psikolog dhe prania e avokatit sigurohej gjithmonë. Nga bisedat konfidenciale me personat e ndaluar/ arrestuar u konstatua që shërbimi psikologjik ishte prezent dhe mjaft aktiv në këtë komisarjat.

E drejta e informimit

Gjatë vizitave të bëra në ambientet e komisarjateve të policisë, u konstatua se në korridore, në zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore, si dhe në dhomat e shoqërimit e të sigurisë ishin afishuar të drejtat e personave të shoqëruar/ të ndaluar/ të arrestuar. Gjatë intervistave të bëra me shtetasit e ndaluar/ arrestuar, një pjesë e tyre pohuan se ishin njohur me të drejtat e tyre nga ana e punonjësve të policisë që në momentin e parë të ndalimit/ arrestimit. Megjithatë, gjatë intervistave të kryera, u konstatuan raste të personave të ndaluar/ të arrestuar, të cilët nuk kishin marrë që në momentin e parë të privimit të lirisë informacionin e nevojshëm për të drejtat e tyre.

⁶ Neni 53 i K.P.P.

Lajmërimi i familjarëve⁷

Nga informacionet e mbledhura gjatë vizitave, u konstatua se disa prej personave të ndaluar/ arrestuar u ishte dhënë mundësia për të folur me një të afërm mbas arrestimit. Megjithatë, nga këqyrja e librit të evidentimit të personave të ndaluar/ arrestuar, u konstatua se një numri të konsiderueshëm të personave të ndaluar/ të arrestuar nuk u ishte ofruar mundësia për të njoftuar familjarët menjëherë pas privimit të tyre nga liria⁸, pasi në regjistrat përkatës mungonte pasqyrimi i njoftimit të familjarëve në kolonën përkatëse.

Gjatë vizitës u konstatua që në ambientet e dhomave të sigurisë në Komisarjatin Shkodër nuk kishte aparat telefonik, me qëllim që të ndaluarit/ arrestuarit të komunikonin me familjarët e tyre⁹.

Shërbimi shëndetësor

Të ndaluarve/ arrestuarve iu bëhej kontrolli mjekësor sipas kërkesave të ligjit (brenda 12 orëve) dhe të dhënat pasqyroheshin në kartelën mjekësore për secilin prej tyre. Në organikën e Drejtorisë së Policisë Qarkut Shkodër kishte një mjek të përgjithshëm. Dhoma e vizitës së mjekut ishte e pajisur me një krevat vizitash, tavolinë, karrige, frigorifer dhe një kuti të ndihmës së shpejtë e cila mbante vetëm disa tableta Paracetamol. Medikamentet e kutisë së ndihmës së shpejtë siguroheshin me fondet e Drejtorisë së Policisë. Dhoma nuk i përmbushte standardet, pasi ishte e ftohtë dhe e papërshtatshme për kryerjen e vizitave mjekësore.

Në ditën e inspektimit, mjeku i Institucionit nuk u gjend në detyrë, ndaj dhe gjithë informacioni në lidhje me shërbimin shëndetësor u mor nga stafi drejtues dhe personeli i dhomave të sigurisë. Nga intervistat me të ndaluarit/ arrestuarit që gjendeshin në dhomat e sigurisë, u konstatua se mjeku i kishte vizituar dhe u kishte dhënë rekomandimet e nevojshme, sipas problematikave, brenda afateve.

Nga këqyrja e dokumentacionit të mjekut u konstatua se regjistri i vizitave të mjekut dhe kartelat mjekësore mbaheshin me rregull nga ana e tij. Gjithashtu, një kopje e kartelave mjekësore ruhej nga ana e mjekut në dhomën e tij.

Në këtë institucion kishte mangësi në sigurimin e ilaçeve, si të atyre të urgjencës, ashtu dhe të ilaçeve për sëmundjet kronike. Një problematikë e ngritur nga shefi i dhomave të sigurisë, ishte nevojja për trajtim me Metadon të personave abuzues me substanca narkotike dhe vështirësia në sigurimin e këtij medikamenti. Ambulancë për rast urgjence apo për rastet kur policia kryen operacione policore nuk kishte.

⁷ Neni 31, gërma "a" e Kushtetutës

⁸ Neni 255, pika 4 i K.P.P.

⁹ Kreu V, pika 6.1, germa "f" e Manualit

Ambientet e intervistimit:

Në Komisarariat në varësi të drejtorisë së Policisë së Qarkut Shkodër, nuk kishte ambient të veçantë intervistimi të monitoruar për kryerjen e veprimeve procedurale nga Oficerët e Policisë Gjyqësore.

Në zyrat e oficerëve të policisë nuk u gjetën sende apo prova materiale prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët kryhen veprimet procedurale.

Monitorimi i ambienteve të shoqërimit të sigurisë dhe hetimit:

Në Komisarariatet e Policie Malësi e Madhe dhe Pukë nuk kishte kamera vëzhguese për mbikëqyrjen e mbajtjen në kontroll të ambienteve të shoqërimit dhe të intervistimit. Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit me kamera një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Libri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar si dhe trajtimi i të shoqëruarve, ndaluarve/arrestuarve gjatë veprimeve që kryen policia

Në Komisarariat e Policisë Shkodër u konstatua se, libri i shoqërimit, të shtetasve ishte i ndërtuar sipas kërkesave të përcaktuara në legjislacion dhe rregulloren përkatëse por ky libër nuk plotësohej sipas kërkesave të përcaktuara, pasi ai përdorej dhe si libër dinamike ku figuronin edhe regjistrimet e personave që hynin në komisarariat me cilësi të ndryshme nga ajo e personit të shoqëruar sipas parashikimeve ligjore.

Në Komisarariat e Policisë Malësi e Madhe dhe Pukë u konstatua se, libri i shoqërimit nuk ishte i ndërtuar sipas kërkesave ligjore dhe Manualit “Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, pasi ky regjistër ishte i një formati të vjetër. Ai përdorej njëkohësisht për regjistrimin e personave të shoqëruar, të ndaluar/arrestuar. Në këtë rast nuk mund të plotësoheshin të gjitha rubrikat ku duhet të pasqyrohen të dhëna për personat e shoqëruar, pasi instituti i shoqërimit ka të tjera specifika dhe kërkesa ligjore nga ai i të ndaluarve/arrestuarve.

Në rubrikën e njoftimit të familjarëve, jo gjithmonë pasqyrohej saktë, emri, atësia, mbiemri dhe numri i telefonit të personit që ishin njoftuar, si dhe arsyeja e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit. Pavarësisht se nga punonjësit e policisë pretendohet se njoftoheshin familjarët e personave të mbajtur në komisarariatet e policisë, plotësimi i rubrikës së njoftimit të familjarëve sipas kërkesave të lartpërmendura është i domosdoshëm për të evidentuar respektimin e kësaj të drejte.

Gjithashtu edhe fenomeni i konstatuar nga Avokati i Popullit lidhur me orën faktike të ndalimit apo arrestimit në flagrancë të shtetasve, ishte prezent edhe në këtë Drejtori Policie, pasi nga krahasimi që bëri grupi i inspeksionit mes orës së vendosur në procesverbalet e ndalimit apo arrestimit në flagrancë, me orën që shënohet në rubrikën e ndalim/arrestimit në librin e të ndaluarve/arrestuarve u arrit në konkluzionin se, në procesverbalet e ndalimit apo arrestimit në flagrancë nuk vihej ora e çastit të kapjes faktike të personit, por vihej ora e përpilimit të procesverbalit. Bazuar në nenet 144, 250 të K.P.P., shënimi në procesverbal i çastit (orës) së arrestimit në flagrancë ose të ndalimit është një element i rëndësishëm mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Ndërsa në bazë të nenit 258 të K.P.P., nga çasti (ora) e arrestimit ose ndalimit fillon afati i 48-të orëve, brenda të cilës prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.

Librat e ankesave të qytetarëve të shoqëruar, ndaluar/ arrestuar ishin të pranishëm në komisariate, por nuk ishin vënë në përdorim, pasi në ta mungonin shënimet.

Me qëllim zgjidhjen e problemeve të mësipërme, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave nga ana e Dejtorit të Përgjithshëm të Policisë për përcaktimin e rregullave teknike të shoqërimit, evidentimit, mbajtjes dhe trajtimit të personave të shoqëruar në ambjentet e policisë në përmbushje të Nenit 109 pika 8 të Ligjit Nr.108/2014 *“Për Policinë së Shtetit”*.
2. Marrjen e masave për ndërtimin ose rikonstruktimin e ambienteve të shoqërimit në Komisaritet e Policisë Shkodër, Pukë dhe Malësi e Madhe në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”* dhe në Manualin *“Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”*, për të krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe të mitur.

3. Marrjen e masave për ndërtimin e ambienteve të reja të sigurisë në Komisarlatin e Policisë Shkodër sipas kërkesave ligjore dhe Manualit *“Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”*.
4. Marrjen e masave të nevojshme për informimin e të gjithë personave të ndaluar/ arrestuar nga policia mbi të drejtat themelore të tyre që në momentin e parë të kufizimit të lirisë.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e Metadonit dhe medikamenteve bazë për rutinë e ndihmës së shpejtë në Komisarlatin e Policisë Shkodër, në mënyrë që për personat e ndaluar/ arrestuar të ofrohet shërbim mjekësor sipas kërkesave të ligjit.
6. Marrjen e masave për pajisjen dhe plotësimin me përgjegjësi të librit të personave të shoqëruar në Komisarlatet Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë.
7. Marrjen e masave për vënien në përdorim, sa më parë e mundur, të librit të ankesave për personat e shoqëruar, dhe ndaluar/arrestuar në të gjithë Komisarlatet e Policisë në vartësi të Drejtorisë Policisë së Qarkut Shkodër.
8. Marrjen e masave për respektimin e dispozitave ligjore të K.P.P. lidhur me shënimin në procesverbal të çastit (orës së saktë) të arrestimit apo ndalimit të shtetasve, duke mos i trajtuar fillimisht si të shoqëruar.
9. Marrjen e masave për vendosjen e sistemit të monitorimit në ambientet e shoqërimit, sigurisë dhe në veçanti atij të marrjes në pyetje në Komisarlatet e Policisë Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë.
10. Marrjen e masave për krijimin e dhomave të marrjes në pyetje të shtetasve nga Oficerët e Policisë Gjyqësore, në Drejtorinë e Policisë Qarkut Shkodër dhe në komisarlatet në varësi të saj.
11. Marrjen e masave të nevojshme nga organet policore për të ofruar një listë me kontakte të avokatëve mbrojtës, si dhe për mundësuar praninë e avokatëve të përzgjedhur gjatë procesit të marrjes në pyetje.
12. Marrjen e masave të nevojshme për të pasqyruar qartësisht kontaktet me familjarët në procesverbalet përkatëse dhe në regjistrat e shtetasve të shoqëruar/ ndaluar/ arrestuar.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Në mungesë dhe me Porosi

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI